

KALENDARI MUJOR



NËNSHKRIMI I NJË ANEKS MARRËVESHJEJE BASHKËPUNIMI MIDIS OBI – DPPI

Më 18 mars 2026, në kuadër të takimit të Këshillit Administrativ të Zyrës Evropiane të Patentave në Mynih, u nënshkrua një Aneks marrëveshje nga Drejtoresha e Përgjithshme e komanduar e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë (DPPI), znj. Rudina Bollano, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Helenike të Pronësisë Industriale të Republikës së Greqisë (OBI), z. Panagiotis Kanellopoulos.

Zyrat ranë dakord të zgjerojnë bashkëpunimin në fushën e patentave. Kërkimet mbi arritjet e mëparshme (state-of-the-art searches) dhe patentueshmërisë do të përgatiten nga OBI duke filluar nga data 1 prill 2026, me kërkesë të aplikantëve të interesuar në Shqipëri .

Kjo marrëveshje është në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet zyrave në vitin 2021 dhe pasqyron angazhimin e tyre për promovimin e inovacionit dhe forcimin e ekosistemit të pronësisë intelektuale.

Pritet që kjo marreveshje të lehtësojë depozitimin e aplikimeve cilësore për patenta, duke shfrytëzuar informacionin e patentave dhe duke ulur rrezikun e shkeljes së teknologjive ekzistuese të patentuara, ndërsa kërkimet e patentueshmërisë do të sjellin vlerë të shtuar për sistemin kombëtar të patentave duke garantuar dhënien e patentave cilësore.

KOMERCIALIZIMI DHE BRANDIMI I TREGUESVE GJEOGRAFIKË (TGJ)



Një tryezë diskutimi e nivelit të lartë që bëri bashkë ekspertë ndërkombëtarë të WIPO-s, institucione shtetërore, akademikë dhe prodhues vendas. Fokusimi kryesor ishte transformimi i produkteve tradicionale shqiptare në marka (brande) të suksesshme për tregun global.



Pikat Kyçe:

Strategjitë e Brandimit: Si të përdoret TGJ-ja si mjet marketingu për rritjen e vlerës së produktit.

Depërtimi në Tregje: Shfrytëzimi i potencialeve që ofron mbrojtja ligjore për eksport.

Rast Studimi (Model): Analizë e veçantë për vajin e ullirit “Valmi Elbasan”. Si një model premtues për zhvillim ekonomik dhe brandim territorial.

Pjesëmarrësit:

Ekspertë nga WIPO & DPPI

Përfaqësues të Universiteve

Grupe prodhuesish nga zonat me traditë

Qëllimi: Fuqizimi i identitetit të produkteve shqiptare dhe krijimi i një platforme bashkëpunimi mes aktorëve të sektorit publik dhe privat.





Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), në bashkëpunim me Administratën Kombëtare të Pronësisë Intelektuale të Kinës, njofton hapjen e thirrjes për programin "Belt and Road Master Program on Intellectual Property". Ky program studimi financohet plotësisht nga qeveria kineze dhe synon kualifikimin e specialistëve në fushën e drejtësisë dhe pronësisë intelektuale.

Institucionet dhe Kohëzgjatja

Studimet do të kryhen në dy nga universitetet më prestigjioze në Kinë, me mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Pronësisë Intelektuale në Shangai:

Tongji University (Shangai): Fokus në inxhinieri dhe arkitekturë.

Zhongnan University of Economics and Law (Wuhan): Fokus në ekonomi dhe drejtësi.

Programi zgjat dy vite dhe zhvillohet tërësisht në gjuhën angleze. Viti i parë parashikon studime prezente në Kinë, ndërsa viti i dytë i kushtohet praktikës dhe mbrojtjes së tezës, e cila mund të kryhet online.

Përfitimet e Bursës

Kandidatët fitues do të përfitojnë një paketë të plotë mbështetëse që përfshin:

Mbulimin e plotë të tarifës së studimit.

Akomodim falas gjatë vitit të parë të qëndrimit në Kinë.

Pagesë mujore për shpenzimet e jetesës (rreth 3000 CNY).

Sigurim shëndetësor të plotë.

Pas përfundimit të studimeve dhe marrjes së diplomës Master në Drejtësi (LL.M), studentët do të kenë mundësi punësimi në institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare dhe kompani lider në fushën e pronësisë intelektuale.

Procedura e Aplikimit:

DPPI do të përzgjedhë deri në dy kandidatë për të vijuar procesin e mëtejshëm. Të interesuarit duhet të dërgojnë dokumentacionin e tyre në adresën zyrtare të emailit: info@dppi.gov.al.

Për të shkarkuar formularët e nevojshëm dhe për t'u njohur me listën e plotë të dokumenteve, vizitoni faqen zyrtare: <https://dppi.gov.al/thirrje-per-aplikime-program-master-ne-pronesine-intelektuale-2026/>

Afati i fundit për aplikim: 15 maj 2026

Mbyllet thirrja për WIPO Global Awards 2026



Më datë 31 Mars 2026, u mbyll zyrtarisht procesi i aplikimeve për "WIPO Global Awards 2026", platforma ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale që synoi vlerësimin e projekteve inovative dhe kreative me ndikim global.

Kjo thirrje u drejtua startup-eve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME) që kanë integruar suksesshëm pronësinë intelektuale në strategjitë e tyre të zhvillimit.

Përmbledhje e Programit dhe Përfitimeve

Gjatë periudhës së aplikimit, bizneset pjesëmarrëse patën mundësinë të konkurronin për një paketë të gjerë përfitimesh, të cilat përfshinin:

Ekspozim Ndërkombëtar: Mundësinë për të promovuar markën e tyre në një skenë globale.

Mentorim Profesional: Këshillim të personalizuar "1:1" nga ekspertë të fushës për zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Lidhje me Investitorët: Akses në rrjete ndërkombëtare biznesi dhe mundësi networking-u me investitorë potencialë.

Pjesëmarrje në Gjenevë: Ftesën për të qenë pjesë e ceremonisë prestigjioze të ndarjes së çmimeve në Zvicër.

Përfundimi i Procesit

Aplikimi për këtë edicion ishte i hapur për të gjitha bizneset me vizion që synonin ta kthenin inovacionin në një mjet rritjeje ekonomike, pa asnjë tarifë pjesëmarrjeje.

Pas kalimit të afatit të fundit, projektet e dorëzuara kanë kaluar në fazën e shqyrtimit nga juria ndërkombëtare e WIPO-s. Të gjithë aplikantët mund të ndjekin njoftimet e mëtejshme rreth shpalljes së fituesve në faqen zyrtare:

wipo.int/en/web/awards/global

Raporti i EPO 2025: Inovacioni arriti shifra rekord



Zyra Evropiane e Patentave (EPO) publikoi raportin vjetor Technology Dashboard, i cili pasqyroj një rritje historike të aktiviteti inovativ gjatë vitit 2025. Për herë të parë në historinë e këtij institucioni, numri i aplikimeve për patenta kaloi pragun e 200,000 kërkesave, duke shënuar një rritje prej 1.4% në krahasim me vitin paraardhës.

Sektorët Dominues dhe Trendet e Teknologjisë

Sipas të dhënave të publikuara, fusha e teknologjisë kompjuterike dhe Inteligjenca Artificiale udhëhoqën garën e inovacionit. Ndërkohë, rritja më e lartë u regjistrua në sektorin e komunikimit digjital me një rritje prej 11.4%.

Në fushën e energjisë, teknologjia e baterive konfirmoi dominimin e saj, duke zënë 45% të të gjitha aplikimeve në sektorin elektrik. Këto shifra dëshmuar orientimin e qartë të industrisë globale drejt digjitalizimit dhe zgjidhjeve të qëndrueshme energjetike.

Gjeografia e Inovacionit dhe Përfshirja Gjimore

Shtetet e Bashkuara të Amerikës ruajtën pozicionin e parë për numrin e aplikimeve, të ndjekura nga Kina, Japonia dhe Koreja e Jugut. Një tregues pozitiv u vu re edhe në aspektin gjinor, ku 26% e aplikimeve evropiane përfshinin të paktën një grua në ekipin e shpikësve.

Suksesi i Patentës Unitare

Raporti nënvizoi gjithashtu suksesin e Patentës Unitare, e cila u mirëprit veçanërisht nga ndërmarrjet e vogla e të mesme (SME) dhe universitetet. Pothuajse gjysma e këtyre subjekteve zgjodhën mbrojtjen e unifikuar evropiane, duke thjeshtuar procedurat dhe ulur kostot e mbrojtjes së pronësisë intelektuale në Bashkimin Evropian.

Ngjarjet e Rëndësishme

Si pjesë e prezantimit të këtyre të dhënave, më datë 24 mars 2026, u mbajt event i live në Euronews me titull Nga kërkimi te ndikimi global, ku u diskutua mbi rrugëtimin e shpikjeve nga laboratorit deri në tregun ndërkombëtar.

Përmbyllja e Praktikës Profesionale "Pan-European Seal"



Drejtoritë jonë njofton me kënaqësi përfundimin me sukses të praktikës profesionale dymujore të z. Geri Lala, i cili u bë pjesë e Sektorit të Patentave në kuadër të projektit prestigjioz ndërkombëtar “Pan-European Seal – Seconded Young Professional”. Ky program, i cili bashkon institucionet më të larta të pronësisë intelektuale në Evropë, i dha mundësinë praktikantit të përfshihet aktivisht në dinamikat komplekse të mbrojtjes së shpikjeve dhe inovacionit. Gjatë kësaj periudhe, Geri tregoi një angazhim të lartë duke u njohur nga afër me procedurat teknike të klasifikimit dhe ekzaminimit, duke sjellë në vëmendje standardet më të avancuara që aplikohen sot nga Organizata Evropiane e Patentave (EPO). Integrimi i këtyre praktikave evropiane në punën e përditshme të institucionit tonë jo vetëm që rrit cilësinë e shërbimit, por shërben edhe si një urë lidhëse për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe proceseve tona me ato ndërkombëtare. Përmes kësaj përvoje, ai pati mundësinë të trajtonte çështje specifike të mbrojtjes së pronësisë industriale, duke treguar një aftësi të shkëlqyer analitike në vlerësimin e risive teknologjike dhe aplikimeve për patentë. Institucioni ynë mbetet i angazhuar në mbështetjen e talenteve të reja dhe në thithjen e ekspertizës ndërkombëtare për të garantuar një mjedis sa më të sigurt dhe inovativ për të gjithë shpikësit dhe sipërmarrësit, i urojmë Gerit shumë suksese dhe arritje të reja në rrugëtimin e tij profesional.

Rrit njohuritë, fuqizo idetë, mbro inovacionin!



Qendra jonë e Trajnimeve njofton hapjen e aplikimeve për ciklin e ri të trajnimeve në fushën e Pronësisë Industriale.

Gjatë këtij muaji, ne do të mirëpresim studentë, sipërmarrës dhe profesionistë që synojnë të kthejnë kreativitetin në aset ekonomik.

Përgjatë sesioneve tona intensive, pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri praktike mbi procedurat e mbrojtjes së shpikjeve përmes patentave, strategjitë për ndërtimin dhe menaxhimin e markave, si dhe metodat më efektive për monetizimin e pronësisë intelektuale.

Ky është një investim i rëndësishëm për këdo që operon në botën e startup-eve, administratës apo sektorit privat, duke u udhëhequr nga ekspertët më të mirë të fushës.

Aplikimet janë tashmë të hapura dhe mund të kryhen shpejt e lehtësisht përmes platformës e-Albania. Mos e lini për momentin e fundit – siguroni vendin tuaj sot për të garantuar suksesin e ideve tuaja nesër!

Mos e humb këtë mundësi – apliko tani!

Program i ri ndërkombëtar Master në Pronësi Intelektuale!



HIPO
Hungarian Intellectual
Property Office



Një mundësi e shkëlqyer studimi në Budapest për profesionistët e ardhshëm të inovacionit!

Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë midis Drejtorisë sonë (DPPI) dhe Zyrës Hungareze për Pronësi Intelektuale (HIPO), jemi të lumtur të ndajmë një mundësi unike edukimi për të gjithë ata që synojnë të specializohen në fushën e ligjit, biznesit dhe inovacionit. Universiteti Corvinus i Budapestit, në partneritet me WIPO dhe HIPO, hap aplikimet për programin Master Shkencor (MSc) në Menaxhimin e Pronësisë Intelektuale, i cili do të nisë në shtator 2026.

Ky program i zhvilluar tërësisht në gjuhën angleze ofron një qasje multidisiplinare, duke ndërthurur njohuritë ligjore me ato ekonomike për t'i pajisur studentët me aftësi praktike në mbrojtjen, vlerësimin dhe licencimin e aseteve intelektuale.

Ky master është krijuar posaçërisht për të përgatitur liderët e ardhshëm që do ta trajtojnë pronësinë intelektuale si një aset strategjik për zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë në tregun global.

Të gjithë të interesuarit mund të gjejnë informacionin e plotë mbi kriteret dhe procesin e aplikimit në faqen zyrtare të Universitetit Corvinus. Mos e humbisni këtë shans për të fituar një eksperiencë ndërkombëtare dhe për t'u bërë pjesë e një rrjeti elitare profesionistësh në fushën e teknologjisë dhe inovacionit!

Më shumë informacion:

<https://www.uni-corvinus.hu/post/landing-page/masters/msc-in-intellectual-property-management/?lang=en>